



Republika Kosovo
Republika e Kosoves
Republic of Kosovo

02-017/2026	
Reg./Nr./No. d.	Br./Nr./No./
30.01.2026	
Opština Ranilug - KOMUNA E RANILLUGUT	

Opština Ranilug
Komuna e Ranillugut
Municipality of Ranilug



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika (d), nenit 61, paragrafi 3, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenit 5, paragrafi 2 dhe nenit 6, paragrafi 2, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 03/2023 për procedurën e emërimit të zëvendëskryetarëve të komunave, nenit 15, paragrafi 15.1 dhe nenit 35, paragrafi 3, të Statutit të Komunës së Ranillugut nr. 02-154/2011, Kuvendi i Komunës së Ranillugut, në mbledhjen e parë të rregullt të mbajtur më 30.01.2026, ka miratuar:

V E N D I M P Ë R
EMËRIMIN E ZËVENDËSKRYETARIT TË KOMUNËS SË RANILLUGUT PËR
KOMUNITETE

1.

Propozimi i paraqitur ka kaluar shqyrtimin kryesor në mbledhjen e parë të rregullt të Kuvendit të Komunës së Ranillugut, të mbajtur më 30.01.2026, ku është aprovuar dhe miratuar njëzëri.

2.

Me këtë vendim emërohet Arton Dubova nga Ropotov e vogel-Dubovcë, në detyrën e Zëvendëskryetarit të Komunës së Ranillugut për komunitete.

3.

Zëvendëskryetari i komunës për komunitete nga pika 2 e këtij Vendimi emërohet për periudhën deri në përfundimin e mandatit të Kryetarit të Komunës së Ranillugut.

4.

Zëvendëskryetari i komunës për komunitete është i obliguar që detyrat e tij t'i ushtrojë në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, Udhëzimin Administrativ (MAPL) për procedurën e emërimit të zëvendëskryetarëve të komunave nr. 03/2023 dhe Statutin e Komunës së Ranillugut nr. 02-154/2011.

5.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës së Ranillugut.

6.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit në Kuvendin e Komunës.

Data: 30.01.2026

Ranillug

Kryesues i KK së Ranillugut



Ivan Krstiq